


Datë 05. 01. 2024



Lënda: Kërkesë për dhënie informacioni

Kërkues: A D , gazetar. Nr kontakti:

Drejtuar: Koordinatorës për të drejtën e informimit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Koordinatori për të drejtën e informimit
Joniada Koçi

Baza ligjore:

-Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

-Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit.

Objekti: Kërkesë për informacion

Ju drejtohem me ane te kësaj kërkesë për një çështje tepër sensitive për opinionin publik e cila cenon rënde sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë procesit të vetingut, për çdo magjistrat që përballëj me procesin e vetingut në dijeninë tonë ishte detyrë e drejtorisë DSIK të informonte për çdo informacion që kishte për magjistratët.

Në rastin e prokurorit K B , a ka informuar DSIK se ky shtetas në datë 24.02.2012 ka udhëtuar drejt Greqisë me shtetasin E B G i cili është person me precedent penale në fushën e trafikut të narkotikëve dhe kategorizohet si kontakt i papërshtatshëm, kontakt i cili cënon pastërtinë e figurës së prokurorit, detyrë kjo e drejtpërdrejtë e DSIK?

A jeni të informuar se prokurori K N B ka pasur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, kontakte të cilat nuk i ka deklaruar në formularin e pastërtisë së figurës edhe pse është detyrim ligjor dhe mosdeklarimi përbën vepër penale?

A jeni në dijeni se prokurori K B në formularin e pastërtisë së figurës është pyetur nëse ka pasur ose jo kontakte me persona të implikuar në krimin e organizuar dhe në këtë formular ai ka mohuar të ketë kontakte ndërkohë që ka artikuj gazetash konkretisht (<https://shqiptarja.com/la/jm/ofl-u-kwrkon-tw-justufikojnw-pasurinw-dy-tw-dwnuarve-pwr-trafik-droge>)(<https://www.oranews.tv/tirane-rrembehet-43-vjecari-te-liqeni-i-denuar-ne-itali-per-trafik-droge>) që informojnë publikun se shtetasi E G është person i implikuar në krimin e organizuar ndërkohë që edhe në vitin 2019 ka qenë objekt i OFL?

A jeni në dijeni se prokurori K B është ndaluar nga policia greke së bashku me R C , S M S Sh në orën 23:05 të datës 25.02.2012 në qytetin e Glyfadhes?

A i keni patur këto fakte në dispozicion në procesin e Vetingut për prokurorin Z.K. B ?

A jeni vene ne dijeni qe F G eshte hetuar nga prokuroria e Beratit ne vitin 2016 ? (<https://www.hashtag.al/wp-content/uploads/2023/12/PADIA-SPAK.pdf>)

A jeni ne dijeni qe R C (oficer policie gjyqesore) ka qene dhe hetuesi i çështjes te vete mikut te tij E G ?

Çfarë masash parashikohen për një magjistrat, për të cilin pasi është konfirmuar në detyrë, zbulohen fakte dhe rrethana të reja, të cilat nëse do të ishin zbuluar më herët, mund të kishim një vendimmarrje tjetër?